



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për
Pranimin e Materialit P1046**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 mars 2024, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve,¹ Trupi Gjykses lëshoi urdhrin gojor për pranimin si provë të materialit P1046 ("Vendimi i Kundërshtuar").²
2. Më 25 mars 2024, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") dorëzoi kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").³
3. Më 4 prill 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") u përgjigj ndaj Kërkesës ("Përgjigjja").⁴
4. Mbrojtja e Veselit nuk u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes.

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me pikat në vijim (bashkërisht, "pikat"):

- 1) nëse Trupi Gjykses gaboi që: (i) vendosi mbi pranueshmërinë para marrjes në pyetje të W04811-shit nga pala jothirrëse; dhe që (ii) nuk i dha Mbrojtjes së Veselit

¹ Transkripti i seancës, 18 mars 2024 ("Transkripti i 18 marsit 2024"), f. 13143, rreshti 1 deri në f. 13147, rreshti 24 dhe f. 13181, rreshti 15 deri në f. 13183, rreshti 8, konfidencial.

² Transkripti i 18 marsit 2024, f. 13183, rreshtat 10-16. *Shih gjithashtu* transkriptin e 18 marsit 2024, f. 13184, rreshtat 5-6.

³ F02198, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046*, 25 mars 2024, konfidenciale.

⁴ F02222, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046 (F02198)*, 4 prill 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 prill 2024, F02222/RED).

kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur ndaj parashtrimeve të ZPS-së lidhur me pranueshmërinë ("pika e parë");

2) nëse Trupi Gjykses gaboi në arsyetim kur vendosi të pranonte materialin P1046 ("pika e dytë"); dhe

3) nëse Trupi Gjykses gaboi që nuk dha arsyet e vendimit për të pranuar materialin P1046 ("pika e tretë").⁵

6. Mbrojtja e Veselit parashtron se pikat përmbushin kriteret për leje për apelim sepse: (i) burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk janë thjesht mospajtim me të;⁶ (ii) mund të ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;⁷ dhe (iii) bëjnë të nevojshme marrjen e një vendimi të menjëhershëm nga Gjykata e Apelit për të avancuar thelbësisht procesin gjyqësor.⁸

7. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të hidhet poshtë, sepse pikat nuk përmbushin standardin e përcaktuar në nenin 45(2) dhe rregullën 77(2).⁹ ZPS-ja parashtron se miratimi i lejes për apelim të vendimeve mbi pranueshmërinë e provave duhet të jetë përjashtim absolut dhe se Mbrojtja e Veselit nuk ka dhënë arsye që përlligjin përdorimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të

⁵ Kërkesa, para. 1-2, 24.

⁶ Kërkesa, para. 6, 7-20.

⁷ Kërkesa, para. 6, 21.

⁸ Kërkesa, para. 6, 22.

⁹ Përgjigja, para. 1, 11.

¹⁰ Përgjigja, para. 1, 9.

cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

9. Trupi Gjykues përfshin përmes referencave dispozitat ligjore përkatëse mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, të përcaktuar në vendimet e tij të mëparshme.¹¹

IV. DISKUTIM

10. Fillimisht, Trupi Gjykues rikujton se gjykuesit e fakteve gëzojnë kompetencë të konsiderueshme diskrecionale në marrjen e vendimit për pranimin ose mospranimin e provave, dhe se leje për apelimin e vendimeve mbi pranueshmërinë miratohet vetëm në raste të jashtëzakonshme.¹² Këto parime pasqyrohen në vlerësimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se “ndërhyrja e apelit për vendimet në lidhje me pranimin e provave përlijet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.”¹³

A. PIKA E PARË

11. Mbrojtja e Veselit parashtron se duke zgjedhur të dëgjonte vetëm përgjigjet e dëshmitarit gjatë pyetjeve të palës thirrëse në lidhje me materialin P1046 dhe duke

¹¹ F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para 7-8; KSC-BC-2020-07, F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. Shih gjithashtu F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

¹² F02157, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960 (“Vendimi i 29 Shkurtit 2024”)*, 29 shkurt 2024, para. 11 dhe poshtëshënimi 26 (me referenca të mëtejshme). Shih gjithashtu ICTR, *Nyiramasuhuko v. Prosecutor*, ICTR-98-42-AR73.2, Appeals Chamber, [Decision on Pauline Nyiramasuhuko’s Appeal on the Admissibility of Evidence](#), 4 October 2004, para. 5.

¹³ KSC-CA-2022-01, F00114, Gjykata e Apelit, *Aktgjykimi i Apelit*, 2 shkurt 2023, para. 35. Shih gjithashtu Vendimin e 29 Shkurtit 2024, para. 11; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 533.

mos i dhënë Mbrojtjes së Veselit kohë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur si duhet argumenteve të ZPS-së, Trupi Gjykses refuzoi të dëgjonte dëshmi relevante të dëshmitarit dhe argumentet e Mbrojtjes së Veselit para marrjes së vendimit mbi pranueshmërinë e materialit P1046.¹⁴ Sipas Mbrojtjes së Veselit, kjo bie ndesh me parimet themelore të drejtësisë së procesit.¹⁵

12. ZPS-ja përgjigjet se elementi i parë i pikës së parë nuk është i apelueshëm sepse është thjesht mospajtim me vendimin e Trupit Gjykses dhe mbështetet, pjesërisht, në argumentin e shqyrtuar më herët se prova të gabimeve faktike në dokument cenojnë autenticitetin e tij.¹⁶ ZPS-ja më tej argumenton se, meqenëse nuk vuri në dukje asnjë dëm, Mbrojtja e Veselit nuk ka demonstruar se pika do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit.¹⁷ Për sa i përket elementit të dytë, ZPS-ja parashtro se: (i) Mbrojtja e Veselit pati mundësinë dhe bëri parashtrimet për pranueshmërinë e materialit P1046; dhe (ii) më pas, Trupi Gjykses ushtroi diskrecionin e tij dhe vendosi se ishte përmbushur standardi *prima facie*.¹⁸

13. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se lëshoi Vendimin e Kundërshtuar pasi ZPS-ja paraqiti dokumentin për pranim si provë dhe pasi dëgjoi parashtrimet e palëve për pranueshmërinë e dokumentit.¹⁹ Mbrojtjes së Veselit iu dha mundësia në *dy* raste të bënte parashtrime me gojë për pranueshmërinë e dokumentit.²⁰ Para marrjes së vendimit për pranimin e provës materiale, Trupi Gjykses gjithashtu

¹⁴ Kërkesa, para. 14. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 7-13.

¹⁵ Kërkesa, para. 14.

¹⁶ Përgjigja, para. 2.

¹⁷ Përgjigja, para. 2.

¹⁸ Përgjigja, para. 3-4.

¹⁹ Transkripti i 18 marsit 2024, f. 13143, rreshti 1 deri në f. 13147, rreshti 24; f. 13181, rreshti 15 deri në f. 13183, rreshti 8.

²⁰ Transkripti i 18 marsit 2024, f. 13143, rreshti 1 deri në f. 13146, rreshti 19; f. 13182, rreshti 23 deri në f. 13183, rreshti 8.

dëgjoi dëshminë e gjerë të W04811 lidhur me materialin P1046 gjatë marrjes në pyetje nga pala thirrëse.²¹

14. Në pikën e parë, Mbrojtja e Veselit në thelb kundërshton kohën e marrjes së Vendimit të Kundërshtuar, me argumentin se Trupi Gjykses duhej ta kishte shtyrë marrjen e vendimit për pranueshmërinë e materialit P1046 deri pasi të kishte dëgjuar dëshminë e dëshmitarit gjatë pyetjeve të palës jothirrëse dhe pasi t'i kishte dhënë Mbrojtjes së Veselit më shumë kohë për t'u përgatitur për parashtrime gojore të mëtejshme lidhur me pranueshmërinë e materialit. Për këtë arsye, dhe megjithëse përkon pjesërisht me argumentet e paraqitura gojarisht nga Mbrojtja e Veselit të cilat Trupi Gjykses, të paktën në mënyrë të tërthortë, i hodhi poshtë, Trupi Gjykses gjykon se pika e parë nuk është thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar por përbën një pikë të veçantë që buron nga ai vendim.

15. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses rikujton se Vendimin e Kundërshtuar e lëshoi pasi dëgjoi parashtrimet gojore të palëve lidhur me pranueshmërinë e materialit, përfshirë edhe parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit të bëra në dy raste më vete.²² Gjithashtu, pasaktësitë e pretenduara në dokumentin përkatës ishin sjellë më herët në vëmendje të Trupit Gjykses, dhe ato u trajtuan më tej gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala thirrëse.²³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ishte në dijeni të problemeve në lidhje me dokumentin dhe gjithsesi u bind se ishin përmbushur kriteret e rregullës 138 për pranueshmërinë e tij.²⁴ Pasi ishte bindur në atë moment se ishin përmbushur kriteret e rregullës 138, Trupi Gjykses nuk kishte arsye të shtynte për më vonë vendimin për pranimin e dokumentit. Rregullorja nuk kërkon që pranimi i provave të propozuara të shtyhet deri pas marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala

²¹ Transkripti i 18 marsit 2024, f. 13173, rreshti 1 deri në f. 13181, rreshti 14.

²² *Shih* më lart, para. 13.

²³ *Shih për shembull* transkriptin e 18 marsit 2024, f. 13145, rreshti 24 deri në f. 13146, rreshti 2; f. 13175, rreshtat 5-10; f. 13175, rreshti 24 deri në f. 13176, rreshti 15; f. 13177, rreshtat 1-8.

²⁴ Vendimi i Kundërshtuar, f. 13183, rreshtat 11-13.

jothirrëse, edhe pse Trupi Gjykses mund, në bazë të diskrecionit të vet, të vendosë ta bëjë këtë.²⁵ Në fakt, marrja e vendimit për pranimin e një dokumenti në kohën kur paraqitet për pranim si provë, është në përputhje të plotë me parimin e përcaktuar në paragrafin 119 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit.²⁶ Kjo është gjithashtu në përputhje me qasjen e përgjithshme të deritanishme të Trupit Gjykses. Mbrojtja e Veselit nuk paraqiti asnjë burim ligjor në mbështetje të pretendimit se Trupi Gjykses duhej ta kishte shtyrë marrjen e vendimit për pranimin e materialit P1946 deri pas përfundimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala jothirrëse, ose se Trupi Gjykses keqpërdori diskrecionin e vet kur vendosi për pranueshmërinë e këtij materiali në atë kohë.

16. Mbrojtja gjithashtu nuk vërtetoi se iu shkaktua padrejtësi si pasojë e procedurës së ndjekur. Trupi Gjykses thekson në këtë kontekst se Mbrojtja e Veselit pati mundësinë të merrte në pyetje dëshmitarin lidhur me materialin P1046²⁷ dhe se dëshmia që dha dëshmitarit në lidhje me këtë aspekt gjithashtu do të mbahet parasysh nga Trupi Gjykses kur të përcaktojë se çfarë peshe do t'i japë kësaj prove materiale. Gjithashtu, palët do të kenë mundësi të plotë e të drejtë për të bërë parashtime në lidhje me peshën që duhet t'i jepet këtij dokumenti në fazën përkatëse të procesit.

17. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit nuk ka vërtetuar se si pika e parë do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit. Rrjedhimisht, kriteri tjetër i standardit të lejes për apelim që buron nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) nuk ka

²⁵ *Shih, në veçanti*, F01226/A01, Trupi Gjykses, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit* ("Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit"), 25 janar 2023, para. 119, ku thuhet si vijon: "Në përgjithësi, Trupi Gjykses shqyrton parashtimet për pranueshmërinë e provave materiale të palëve dhe të pjesëmarrësve dhe vendos lidhur me to në kohën kur provat materiale paraqiten si prova. Kur është më praktike, Trupi Gjykses mund të shtyjë marrjen e vendimit lidhur me pranueshmërinë deri në përfundim të dëshmisë së dëshmitarit."

²⁶ *Shih më lart*, poshtëshënimi 25.

²⁷ Transkripti i 18 marsit 2024, f. 13217, rreshti 24 deri në f. 13222, rreshti 7.

nevojë të trajtohet në lidhje me pikën e parë. Kërkesa për leje për apelim të pikës së parë hidhet poshtë.

B. PIKA E DYTË

18. Mbrojtja e Veselit parashtron se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se autenticiteti i materialit P1046 është i qartë, pa pasur në dispozicion prova që mbështesin këtë konstatim.²⁸ Në veçanti, Mbrojtja e Veselit pretendon se: (i) ZPS-ja nuk paraqiti asnjë provë lidhur me autorësinë dhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të materialit; (ii) përmbajtja e dokumentit nuk ishte e saktë; dhe se (iii) W04811 nuk dha dëshmi në mbështetje të autenticitetit të materialit, dhe autenticiteti i materialit nuk mund të konfirmohet nga provat në këtë çështje gjyqësore.²⁹

19. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Veselit: (i) nuk evidenton një pikë konkrete ose të identifikueshme; ose (ii) nuk vërteton se çështja ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit.³⁰ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Mbrojtja e Veselit shpreh thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar pa identifikuar ndonjë gabim të apelueshëm.³¹ Gjithashtu, ajo argumenton se pretendimi i Mbrojtjes së Veselit që ndërhyrja e apelit në këtë fazë të procesit do të parandalonte rrezikun e çdo efekti dëmtues ndaj të akuzuarve, mbështetet në hamendësim, përderisa Trupi Gjykses nuk ka përcaktuar ende se çfarë peshe do t'i japë në fund materialit P1046.³²

20. Trupi Gjykses vëren se në pikën e dytë, Mbrojtja e Veselit argumenton se Trupi Gjykses “gaboi në arsyetimin e vet kur vendosi të pranonte materialin

²⁸ Kërkesa, para 15-18.

²⁹ Kërkesa, para. 17.

³⁰ Përgjigja, para. 5.

³¹ Përgjigja, para. 6.

³² Përgjigja, para. 7.

P1046".³³ Trupi Gjykues është i mendimit se në formulimin e pikës së dytë, Mbrojtja e Veselit nuk e ka identifikuar qartë gabimin që kërkon të apelojë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se pika e dytë, ashtu siç është formuluar nga Mbrojtja e Veselit, nuk është konkrete, e veçantë ose e identifikueshme.³⁴ Për këto arsye, pika e dytë mund të hidhet poshtë *in limine*. Megjithatë, Trupi Gjykues mban parasysh se në parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit lidhur me pikën e dytë është e qartë se kjo pikë lidhet me konstatimin e Trupit Gjykues për autenticitetin, dhe veçanërisht me konstatimin e Trupit Gjykues se autenticiteti i materialit P1046 ishte "i qartë".³⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues do të bëjë përjashtim dhe do t'i shqyrtojë argumentet e paraqitura nga Mbrojtja e Veselit në lidhje me pikën e dytë.

21. Nga Vendimi i Kundërshtuar del qartë se Trupi Gjykues vlerësoi kriterin e pranueshmërisë së materialit P1046 sikurse përcaktohet nga rregulla 138(1).³⁶ Kur vendosi për pranueshmërinë e materialit P1046, përfshirë edhe autenticitetin e tij *prima facie*, Trupi Gjykues tashmë kishte dëgjuar parashtrimet e gjerësishme të palëve për pranueshmërinë e materialit, si dhe ato lidhur me autenticitetin.³⁷ Në parashtrimet me gojë, ZPS-ja trajtoi gjithashtu autorësinë, prejardhjen dhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje (të pretenduara) të dokumentit përkatës, përmendi shembuj të provave konfirmuese, dhe iu referua mocionit për prova jogojore - lidhur me të cilin ende nuk është marrë vendim - që përmban hollësi të mëtjshme për pranueshmërinë e pretenduar të dokumentit.³⁸

22. Për pranimin e një prove, Rregulla 138(1) kërkon vetëm që pala që paraqet provën të vërtetojë autenticitetin *prima facie* të provës. Me fjalë të tjera, ajo nuk

³³ Kërkesa, para. 2(b).

³⁴ Shih gjithashtu, për shembull, Vendimin e 29 Shkurtit 2024, para. 13 dhe poshtëshënimin 34 (me referencat e mëtejshme).

³⁵ Kërkesa, para 16-18.

³⁶ Vendimi i Kundërshtuar, f. 13183, rreshtat 11-13.

³⁷ Transkripti i 18 marsit 2024, f. 13143, rreshti 1 deri në f. 13146, rreshti 19 (Mbrojtja e Veselit); f. 13181, rreshti 15 deri në f. 13182, rreshti 20 (ZPS-ja).

³⁸ F02178/A01, Prokurori i Specializuar, Shtojca 1 e Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Llapit dhe Kërkesës lidhur me To, 14 mars 2024, konfidencial (materiali 107). Shih transkriptin e 18 marsit 2024, f. 13147, rreshtat 15-19; f. 13181, rreshti 17 deri në f. 13182, rreshti 19.

kërkon prova bindëse të autenticitetit të dokumentit, por vetëm konstatim mbi bazën e formës dhe përmbajtjes së dokumentit përkatës si edhe faktorëve të tjerë relevantë për vlerësimin e autenticitetit që i janë paraqitur në mënyrë të vlefshme Trupit Gjykses në kohën e marrjes së vendimit mbi pranueshmërinë. Trupi Gjykses u bind për autenticitetin *prima facie* të materialit P1046 në kohën kur u paraqit si provë.³⁹ Sikurse u shpjegua më lart, para se të merrte vendimin për pranueshmërinë e materialit në fjalë, Trupi Gjykses nuk kishte arsye të shtynte pranimin e provave për më vonë, as të dëgjonte parashtrime shtesë nga palët dhe as të kërkonte prova shtesë nga ky dëshmitar.⁴⁰ Trupi Gjykses është i mendimit se pika e dytë thjesht përsërit kundërshtimin e Mbrojtjes së Veselit ndaj autenticitetit, për të cilin Trupi Gjykses ishte në dijeni kur lëshoi Vendimin e Kundërshtuar,⁴¹ dhe se argumentet e Mbrojtjes keqinterpretojnë standardin e pranueshmërisë së provave materiale të përcaktuar në Rregullore.

23. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses vlerëson se pika e dytë përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar dhe më konkretisht, me konstatimin e Trupit Gjykses lidhur me autenticitetin *prima facie* të materialit, pa identifikuar gabim të apelueshëm. Rrjedhimisht, kriteret e tjera të standardit të lejes për apelim që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e dytë. Kërkesa për leje për apelim të pikës së dytë hidhet poshtë.

C. PIKA E TRETË

24. Mbrojtja e Veselit parashtron se vendimi për pranimin e materialit P1046 është i mangët për shkak se nuk jep arsyet.⁴² Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses: (i) nuk i trajtoi parashtrimet e palëve dhe veçanërisht kundërshtimet e ngritura; (ii) nuk dha arsyet se si dëmi (i pretenduar) që i shkaktohet Mbrojtjes së

³⁹ Shih Vendimin e Kundërshtuar, f. 13183, rreshtat 11-13. Shih gjithashtu më lart, para. 15.

⁴⁰ Shih më lart, para. 15.

⁴¹ Shih transkriptin e 18 marsit 2024, f. 13143, rreshti 1 deri në f. 13146, rreshti 19.

⁴² Kërkesa, para. 19.

Veselit me pranimin e dokumentit, mund të zbutet ose të trajtohet në gjykim; dhe (iii) nuk artikuloi aspektet për të cilat konstatoi se dokumenti është relevant ose provues.⁴³

25. ZPS-ja përgjigjet se nuk janë përmbushur asnjë nga kriteret e lejes për apelim për pikën e tretë.⁴⁴ Ajo parashtron se: (i) Vendimi i Kundërshtuar tregon qartë se Trupi Gjykses shqyrtoi të gjithë faktorët relevantë dhe zbatoi drejt kriteret e rregullës 138; dhe se (ii) ishte brenda diskrecionit të Trupit Gjykses që mos artikulonte çdo detaj në mbështetje të vendimit të tij për pranimin e dokumentit.⁴⁵

26. Vendimi i Kundërshtuar tregon qartë se Trupi Gjykses shqyrtoi të gjithë faktorët relevantë kur vendosi për pranueshmërinë e materialit P1046 sipas rregullës 138.⁴⁶ Megjithatë, Trupi Gjykses vlerëson se pika e tretë, ku pretendohet se kur lëshoi Vendimi e Kundërshtuar, Trupi Gjykses gaboi që nuk lëshoi një vendim (mjaftueshëm) të arsyetuar, përbën një pikë të veçantë që buron nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk është thjesht mospajtim me të.

27. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses rikujton se Vendimin e Kundërshtuar e lëshoi pasi dëgjoi: (i) parashtrimet e gjerësishme të palëve lidhur me pranueshmërinë e materialit P1046; dhe (ii) dëshminë e W04811-shit gjatë marrjes në pyetje nga pala thirrëse.⁴⁷ Sikurse u vu në dukje më lart, Mbrojtja e Veselit pati mundësinë të merrte në pyetje dëshmitarin lidhur me materialin P1046.⁴⁸ Për më tepër, në fazën përkatëse të procesit, palët do të kenë mundësi të plotë dhe të drejtë për të bërë parashtrime në lidhje me peshën që duhet t'i jepet këtij dokumenti. Faktorët dhe kriteret relevante për vendimin e Trupit Gjykses mbi

⁴³ Kërkesa, para. 20.

⁴⁴ Kërkesa, para. 8.

⁴⁵ Përgjigja, para. 8.

⁴⁶ Vendimi i Kundërshtuar, f. 13183, rreshtat 11-13. *Shih gjithashtu* më lart, para. 21.

⁴⁷ *Shih* më lart, para 13, 15.

⁴⁸ *Shih* më lart, para. 16.

pranueshmërinë e materialit ishin qartësisht të dukshme te vendimi, me anë të cilit duhej vetëm të përcaktonte nëse ishin përmbushur kriteret e rregullës 138 (1) lidhur me atë dokument. Të gjitha argumentet e palëve u mbajtën parasysh kur u morr ai vendim. Sugjerimi se e drejta e të akuzuarit për mendim të arsyetuar i jep zotit Veseli të drejtën për t'iu dhënë më shumë arsye sesa janë dhënë në kontekstin e vendimit për pranimin e provës, është i pabazë.

28. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit nuk ka vërtetuar si pika e tretë do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit. Rrjedhimisht, kriteret e tjera të standardit të lejes për apelim që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e tretë. Kërkesa për leje për apelim të pikës së tretë hidhet poshtë.

V. KLASIFIKIMI

29. Trupi Gjykses vë në dukje se Kërkesa u dorëzua si konfidenciale dhe se deri tani nuk është dorëzuar versionin e redaktuar publik i saj. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen që deri të hënën, 22 prill 2024, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës, ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike. Trupi Gjykses i kujton Mbrojtjes edhe një herë urdhrin gojor në lidhje me parimin e procesit publik, me të cilin Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe pjesëmarrësit, që si parim: (i) të dorëzojnë njëkohësisht edhe versionin e redaktuar publik të parashtrimit konfidencial; dhe (ii) kur ka arsye bindëse për të mos e bërë këtë, në pjesën e parashtrimit për klasifikimin të bëjnë të ditura arsyet pse versionin e redaktuar publik nuk mund të dorëzohet njëkohësisht.⁴⁹

⁴⁹ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, f. 9446, rreshtat 13-20. Shih gjithashtu Vendimin e 29 Shkurtit 2024, para. 18; F02067, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F01963* 19 janar 2024, para. 37.

VI. VENDIMI

30. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

(a) **HEDH POSHTË** Kërkesën; dhe

(b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Veselit të dorëzojë **deri të hënën, 22 prill 2024**, versionin e redaktuar publik të Kërkesës, ose të kërkojë riklasifikimin e saj.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 15 prill 2024

Në Hagë, Holandë.